

Mbledhja e të dhënave gjinore dhe treguesit gjinor në UNIKO

Dr. Denisa Titili

Viola Dolani

Situata e barazisë gjinore dhe politikat institucionale në UNIKO

- Çështjet gjinore nuk janë pjesë e misionit/vizionit të institucionit
- Kodi i Etikës së UNIKO:

*“ Të gjithë anëtarët e Universitetit kanë të drejtë të trajtohen me mirëkuptim, respekt dhe konsideratë të barabartë dhe të mos diskriminohen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për një ose më shumë faktorë, përfshirë fenë, **gjininë, orientimi seksual**, ndërgjegjja dhe besimet, aspekti dhe ngjyra personale, fizike, gjuha, origjina etnike ose sociale, shtetësia, kushtet personale dhe shëndetësore, shtatzënia, zgjedhjet familjare, mosha”.*

- Mungon një strukturë specifike institucionale përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore
- Mungon Plani i Barazisë Gjinore në nivel universiteti

Indekset gjinore

- Studentë të rregjistruar në UNIKO sipas gjinisë dhe fushës së arsimit (2021- 2022)
- Studentë të diplomuar në programet e ciklit të dytë master (MP/MSH) sipas fushës së arsimit
- Treguesi (%) i burrave dhe grave në një karrierë akademike, studentësh dhe stafi akademik
- Treguesi (%) i grave në stafin akademik sipas gradës
- Treguesi i 'Tavanit të qelqit'
- Treguesi i grave në krye bordeve dhe njësite vendimmarrëse në UNIKO

Analiza e treguesve gjinore - Qëllimi

- Analiza e indekseve dhe treguesve gjinore do të bëjë të mundur portretizimin e gjendjes aktuale të UNIKO lidhur me barazinë gjinore
- Do të mundësojë identifikimin e mangësive dhe pengesave që ekzistojnë për barazinë gjinore në këtë institucion
- Kjo analizë e kontekstit do të bëjë të mundur përcaktimin e qëllimeve bazuar në nevojat dhe dobësitë e identifikuara.
- Nevojat e identifikuara do të ndihmojnë në hartimin e Planit të Barazisë Gjinore

Klasifikimi sipas ISCED 2011

- ISCED 6 – Studentë të programeve Bachelor
- ISCED 7 – Studentë të programeve Master
- ISCED 8 – Studentë të programeve doktorale
- Grada C – Kërkues/ Lektorë (Dr.)
- Grada B – Titulli akademik “Profesor i Asociuar”
- Grada A – Titulli akademik “Profesor”

Programet e studimit të klasifikuara sipas ISCED

- Programe të përgjithshme dhe kualifikime
- Edukim
- Arte dhe Humanitete
- Shkenca sociale, gazetari dhe informacion
- Biznes, administrim dhe shkenca juridike
- Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë
- Informatikë dhe teknologji komunikimi
- Inxhinieri dhe ndërtim
- Agronomi, pylltari, akuakulture dhe veterinari
- Shëndetësi
- Shërbime

Tabela I. Studentë të regjistruar në UNIKO sipas gjinisë dhe fushës së arsimit (2021- 2022)

INDEX	Studente te regjistruar ne arsimin universitar sipas gjinise dhe fushes se studimit						
	M	%M	F	%F	Total	%TOT	%F/TOT
Programe te pergjithshme dhe kualifikime							
Edukim	50	13.2%	134	22.0%	184	18.6%	73%
Shkenca humane dhe arte	22	5.8%	26	4.3%	48	4.9%	54%
Shkenca sociale, gazetari, informacion	15	4.0%	28	4.6%	43	4.4%	65%
Biznes, administrim dhe shkenca juridike	132	34.8%	235	38.7%	367	37.2%	64%
Shkenca natyrore, matematike, statistike	12	3.2%	16	2.6%	28	2.8%	57%
Informatike dhe teknologji informacioni	51	13.5%	10	1.6%	61	6.2%	16%
Inxhinieri dhe ndertim							
Agronomi, pylltari, akuakulture, veterinari	69	18.2%	22	3.6%	91	9.2%	24%
Shendetesi	28	7.4%	137	22.5%	165	16.7%	83%
Total	379	100.0%	608	100.0%	987	100.0%	62%

Tabela I. Studentë të regjistruar në UNIKO sipas gjinisë dhe fushës së arsimit

- Të dhënat mbi numrin e studentëve të regjistruar në UNIKO sipas gjinise dhe fushës së arsimit tregojnë se:
- Numri i studenteve vajza është më i lartë pothuaj në të gjitha programet e studimit që ofron UNIKO
- 73% e të regjistruarve në **Edukim** janë vajza
- 83% e të regjistruarve në **Shkencat e shëndetit** janë vajza
- 65 % e të regjistruarve në **Shkencat sociale** janë vajza
- Studentet vajza në UNIKO përfaqësojnë **16% (Informatikë dhe Teknologji Informacioni)** dhe **24% (Agronomi)** të totalit të studentëve në fushat përkatëse

Tabela II. Vajzat në mes të të diplomuarve në nivelin Master (MP/MSH) sipas fushës së studimit

INDEX	Vajzat ne mes te te diplomuave ne nivelin master (MP/MSH) sipas fushes se studimit						
	M	%M/TOT	F	%F/TOT	Total	%TOT	%F/TOT
Programe te pergjithshme dhe kualifikime							
Edukim	24	20%	139	49%	163	41%	85%
Shkenca humane dhe arte	3	3%	10	4%	13	3%	77%
Shkenca sociale, gazetari, informacion	3	3%	7	2%	10	2%	70%
Biznes, administrim dhe shkenca juridike	39	33%	80	28%	119	30%	67%
Shkenca natyrore, matematike, statistike							
Informatike dhe teknologji informacioni	11	9%	0	0%	11	3%	0%
Inxhinieri dhe ndertim							
Agronimi, pylltari, akuakulture, veterinari	30	25%	16	6%	46	11%	35%
Shendetesi	8	7%	31	11%	39	10%	79%
Total	118	100%	283	100%	401	100%	71%

Tabela III. Treguesi (%) i burrave dhe grave në një karrierë akademike, student dhe staf akademik

INDEX:	% e burrave dhe grave ne nje karriere akademike, studentesh dhe stafi akademik (Indeksi kompleks)							
	M	% M	F	% F	Total	%TOT	% M/TOT	% F/ TOT
ISCED 6 Studentet	244	34.2%	332	27.1%	576	29.7%	42.4%	57.6%
ISCED 6 te diplomuarit	179	25.1%	262	21.4%	441	22.8%	40.6%	59.4%
ISCED 7 Studentet	135	18.9%	276	22.6%	411	21.2%	32.8%	67.2%
ISCED 7 te diplomuarit	118	16.5%	283	23.1%	401	20.7%	29.4%	70.6%
Grada C	23	3.2%	52	4.3%	75	3.9%	30.7%	69.3%
Grada B	10	1.4%	17	1.4%	27	1.4%	37.0%	63.0%
Grada A	5	0.7%	1	0.1%	6	0.3%	83.3%	16.7%
Total	714	100%	1223	100%	1937	100%	37%	63.1%

- Të dhënat prej tabelës tregojnë se gratë përfaqësojnë 63.1 % të studentëve dhe stafit akademik të UNIKO
- Referuar të dhënave lidhur me ecurinë në karrrierë sipas gjinisë, duke filluar prej statusit 'student' e në vazhdim lektor (Grada C), profesor i asociuar (Grada B) dhe profesor (Grada A) ka një rënie të përqindjes së grave
- Vihet në dukje një rënie e theksuar e përqindjes së grave në UNIKO në stadin më të lartë të karrrierës akademike, nga 69.3 % Grada C në 63.0% Grada B dhe vetëm 16.7 % Grada A.
- Kalimi nga Profesor i Asociuar në gradën Profesor për bën një fazë kritike për gratë, e cila rezulton me shumë vështirësi për to në kushtet e plotësimit të kriterëve.

Tabela IV. Treguesi (%) i grave midis stafit akademik, sipas gradës

	Proporcioni (%) i grave në stafin akademik sipas gradës							
INDEX:	M	% M	F	% F	Total	% TOT	% M/ TOT	% F/ TOT
Grada C	23	60.5%	52	74.3%	75	69.4%	30.7%	69.3%
Grada B	10	26.3%	17	24.3%	27	25.0%	37.0%	63.0%
Grada A	5	13.2%	1	1.4%	6	5.6%	83.3%	16.7%
Total	38	100%	70	100%	108	100%	35%	64.8%

Tabela tregon se ka një reduktim progresiv në % me rritje të shkallës hirearkike të titujve nga 69.3% (grada C) në 63.0 % (grada B) dhe 16.7 % në Gradën A

Treguesi i Tavanit të qelqit: 3.88

- Përcaktohet si raporti midis treguesit të grave në stafin akademik (grada A + grada B + grada C) dhe treguesit të grave me titull akademik profesor. (grada A).
- Një vlerë më e lartë se 1 tregon praninë e efektit të njohur si "efekti i tavanit të qelqit", i cili i sheh gratë më pak të përfaqësuara me titullin profesor (grada A) sesa treguesi i pranisë së tyre në stafin akademik (grada A + grada B + grada C).
- Sa më e lartë vlera mbi njësinë, e indeksit të Tavanit të Qelqit, aq më i fortë është efekti i tavanit të qelqit dhe aq më e vështirë është që gratë të arrijnë rolin më të lartë në karrierën akademike.
- Indeksi i Tavanit të Qelqit, për UNIKO është 3.88 (64.8%/ 16.7%) Këto të dhëna tregojnë se ka pengesa në progresin e karrierës së grave akademike

Tabela V: Treguesi (%) i stafit të gradës A midis të gjithë stafit akademik sipas gjinisë

INDEX	% e stafit të gradës A midis të gjithë stafit akademik sipas gjinisë		
	M	F	Total
Grada A	5	1	6
Total	54	95	149
% Grada A/ Total	9.2 %	1%	4%

Gratë në krye të bordeve dhe njësive vendimmarrëse të UNIKO

- Në lidhje me përfaqësimin e grave në pozitat vendimmarrëse dhe drejtuese në UNIKO rezulton se:
- Në nivelet më të larta drejtuese (Rektor, Zëvendës Rektor dhe Administrator) raporti i burrave ndaj grave është **3 me 1**
- Në nivel Fakulteti (dekanët) raporti burra / gra është 1 me 3
- Në nivel departamenti (përgjegjës departamenti) raporti burra/ gra është **6 me 9**
- Bordi i Administrimit përbëhet nga **4 gra** dhe 3 burra
- Senati Akademik përbëhet nga **19 anëtarë** nga të cilët **5 femra** dhe 14 meshkuj
- Senati Akademik është organi më i lartë kolegjal vendimmarrës i UNIKO. Të dhënat tregojnë se gratë mbeten të nënperfaqësuar në këtë njësi vendimmarrëse, gjë e cila mund të çojë në disa sugjerime dhe përmirësime në lidhje me promovimin më të mirë të masave për të mbështetur balancën gjinore në menaxhmentin e lartë në Universitet.